

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ALB – USA UNWIRED” SH.P.K

Sot më datë 07. 04.2022, pas diskutimeve paraprake, personat e mëposhtëm:

1. **Z. Christopher David Grant**, i biri i Alan dhe i Marinella, datelindja 18.08.1976, lindur në Auckland, New Zealand, shtetas i New Zealand, me banim të përkohshëm Kosovë, adresa 10 K, Ahmet Krasniqi” Prishtin, Kosovë, identifikuar nëpërmjet pasaportës me Nr. LM207546 madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. **Z. Nenad Rašić**, i biri i Milorad dhe i Slobodanka, datelindja 27.01.1973, lindur dhe banues në Lipjan, Kosovë, me shtetësi kosovare, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektroik me Nr.1501818522, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
3. **Z. Avdi Kosumi**, i biri i Zeqir dhe i Habibe, datelindja 22.05.1966, lindur dhe banues në Gërdoc, Podujevë, Kosovë, me shtetësi kosovare, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik me Nr.1013983093, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
4. **Z. Shaban Nexhi**, i biri i Qazim dhe i Sofie, datelindja 21.09.1970, lindur në Perbreg Kukës, banues në Njësia Ad. Tiranë Nr. 9, Rr: “Muzakët” Nd. 29. H. 9 Ap.7, me shtetësi shqiptare, identifikuar me ID Nr. H00901114P, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
5. **Z. Klodian Maqellara**, i biri i Muhamet dhe i Hanke, datelindja 27.02.1972, lindur në Tiranë, banues në Rr: “Arkitekt Kasemi”, Pall. 29, Shk.1, Ap.13, me shtetësi shqiptare, identifikuar me ID Nr. H20227126L, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Bashkërisht kanë vendosur të nënshkruajnë statusin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sh.p.k, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, nga ky Status dhe Akti i Themelimit.

Neni 1 Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është “ALB – USA UNWIRED” SH.P.K

Neni 2 Selia

Selia e shoqërisë është në adresën: Bulevardi “Zogu i Parë”, Rruga “Urani Pano”, Nd.1, H7, Ap.17, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e pa afat.

Neni 4

Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka si objekt veprimtarie:

Shërbimi me fibër optike, produkte të tjera të teknologjive, antenat, importimin e radiove, dizajnimi dhe implementimi i rrjeteve private "LTE Networks", Marketingu Digjital, Analitika e të dhënave e menaxhimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve 5G, dhe jo vetëm.

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë të reja.

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 5 (pesë) kuota.

Neni 6

Kontributet

Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

1. Z. Christopher Grant, i biri i Alan dhe i Marinella, datelindja 18.08.1976, lindur në Auckland, New Zealand, shtetas i New Zealand, me banim të përkohshëm në Kosovë, adresat 10 K, Ahmet Krasniqi" Prishtin, Kosovë, identifikuar nëpërmjet pasaportës me Nr. LM207546 madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **23%** e kapitalit fillestar prej 23.000 lekë duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.


2. Z. Nenad Rašić, i biri i Milorad dhe i Slobodanka, datëlindja 27.01.1973, lindur dhe banues në Lipjan, Kosovë, me shtetësi kosovare, identifikuar nëpërmjet letërnjoftim me Nr.1501818522, madhor, me zotësi të plotë juridike për të me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **23%** e kapitalit fillestar prej 23.000 lekë duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.

3. Z. Avdi Kosumi, i biri i Zeqir dhe i Habibe, datëlindja 22.05.1966, lindur dhe banues në Gërdoc, Podujevë, Kosovë, me shtetësi kosovare, identifikuar nëpërmjet letërnjoftim me Nr.1013983093, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **10%** e kapitalit fillestar prej 10.000 lekë duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.

4. Z. Shaban Nexhi, i biri i Qazim dhe i Sofie, datëlindja 21.09.1970, lindur në Perbreg Kukës, banues në Njësia Ad. Tiranë Nr.9, Rr: "Muzakët" Nd.29. H.9 Ap.7, me shtetësi shqiptare, identifikuar me ID Nr. H00901114P, madhor, me zotësi të plotë juridike për të me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **41%** e kapitalit fillestar prej 41.000 lekë duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.

5. Z. Klodian Maqellara, i biri i Muhamet dhe i Hanke, datëlindja 27.02.1972, lindur në Tiranë, banues në Rr: "Arkitekt Kasemi", Pall.29, Shk.1, Ap.13, me shtetësi shqiptare, identifikuar me ID Nr. H20227126L, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **3%** e kapitalit fillestar prej 3.000 lekë duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.

Sipas kontributeve të mësipërme:



- **Z. Christopher Grant** do të mbajë 1 kuotë, e cila përfaqëson 23.000 lekë të kapitalit të shoqërisë.
- **Z. Nenad Rašić** do të mbajë 1 kuotë, e cila përfaqëson 23.000 lekë të kapitalit të shoqërisë.
- **Z. Avdi Kosumi** do të mbajë 1 kuotë, e cila përfaqëson 10.000 lekë të kapitalit të shoqërisë.
- **Z. Shaban Nexhi** do të mbajë 1 kuotë, e cila përfaqëson 41.000 lekë të kapitalit të shoqërisë.
- **Z. Klodian Maqellara** do të mbajë 1 kuotë, e cila përfaqëson 3.000 lekë të kapitalit të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8

Administratorët

Me këtë akt emërohet Administrator i shoqërisë personi si më poshtë:

-**Z. Shaban Nexhi**, i biri i Qazim dhe i Sofie, datëlindja 21.09.1970, lindur në Përbreg Kukës, banues në Njësia Ad. Tiranë Nr.9, rr: “Muzakët” Nd.29. H.9 Ap.7, me shtetësi shqiptare, identifikuar me ID Nr. H00901114P, madhor, me zotësi të plotë juridike për të me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Neni 9

Kopetencat e Administratorit

Administrator do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit 9901, datë 14 Prill 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe nenit 14 të Statutit.

Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të shoqërisë “ALB – USA UNWIRED” sh.p.k, në formim e sipër, dhe për regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (në vijim QKB) si dhe ka të drejtë t’i delegojë kompetencat e tij, personave të tjerë.

Neni 10

Legjislacioni




Përsa nuk është shkruar në këtë Akt – Themelimi dhe Statut, do të behët në referim me dispozitat e legjislacionit tregtar të Republikën e Shqipërisë

Neni 11

Gjuha e përdorur

Akti i Themelimit të kësaj shoqërie sh.p.k, është i përpiluar në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe, që kanë vlerë të njëjtë ligjore.

Pasi i lexua, Akti i Themelimi me zë të lartë të pranishmëve, deklaruan se e gjetën atë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre dhe nënshkruhet lirisht nga palët, sipas ligjit.

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ALB – USA UNWIRED” SH.P.K

Sot më datë 07. 04.2022, pas diskutimeve paraprahe, personat e mëposhtëm:

1. **Z. Christopher Grant**, i biri i Alan dhe i Marinella, datelindja 18.08.1976, lindur në Auckland, New Zealand, shtetas i New Zealand, me banim të përkohshëm në Kosovë, adresa 10 K, Ahmet Krasniqi” Prishtin, Kosovë, identifikuar nëpërmjet pasaportës me Nr. LM207546 madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar,
2. **Z. Nenad Rašić**, i biri i Milorad dhe i Slobodanka, datelindja 27.01.1973, lindur dhe banues në Lipjan, Kosovë, me shtetësi kosovare, identifikuar nëpërmjet letërnjoftim me Nr.1501818522, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
3. **Z. Avdi Kosumi**, i biri i Zeqir dhe i Habibe, datelindja 22.05.1966, lindur dhe banues në Gërdoc, Podujevë, Kosovë, me shtetësi kosovare, identifikuar nëpërmjet letërnjoftim me Nr.1013983093, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
4. **Z. Shaban Nexhi**, i biri i Qazim dhe i Sofie, datelindja 21.09.1970, lindur në Përbreg Kukës, banues në Njësia Ad. Tiranë Nr.9, Rr: “Muzakët” Nd.29. H.9 Ap.7, me shtetësi shqiptare, identifikuar me ID Nr. H00901114P, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
5. **Z. Klodian Maqellara**, i biri i Muhamet dhe i Hanke, datelindja 27.02.1972, lindur në Tiranë, banues në Rr: “Arkitekt Kasemi”, Pall.29, Shk.1, Ap.13, me shtetësi shqiptare, identifikuar me ID Nr. H20227126L, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Mbi identitetin e të cilëve unë jam e sigurtë.

Të cilët kanë vendosur të nënshkruajnë Statusin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, nga ky Statut dhe Akti i Themelimit.

KAPITULLI I
THEMELIMI, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA


Neni 1

Themelimi, Forma dhe Ortakët

Sot më datë 07. 04.2022, të nënshkruarit si ortakë themelues të shoqërisë kanë vendosur të krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar emërtimi i së cilës do të jetë **“ALB – USA UNWIRED” SH.P.K**

Shoqëria **“ALB – USA UNWIRED” SH.P.K** (më poshtë do të quhet Shoqëria) është e krijuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga ortakët e mëposhtëm sipas kontributit të mëposhtëm:

1. **Z. Christopher Grant**, i biri i Alan dhe i Marinella, datelindja 18.08.1976, lindur në Auckland, New Zealand, shtetas i New Zealand, me banim të përkohshëm në Kosovë, adresa 10 K, Ahmet Krasniqi” Prishtin, Kosovë, identifikuar nëpërmjet pasaportës me Nr. LM207546 madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut



në para të barabartë **me 23%** e kapitalit fillestar duke depozituar një vlerë prej 23.000 lekë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.

2. Z. Nenad Rašić, i biri i Milorad dhe i Slobodanka, datëlindja 27.01.1973, lindur dhe banues në Lipjan, Kosovë, me shtetësi kosovare, identifikuar nëpërmjet letërnjoftim me Nr.1501818522, madhor, me zotësi të plotë juridike për të me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **23%** e kapitalit fillestar duke depozituar një vlerë prej 23.000 lekë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.

3. Z. Avdi Kosumi, i biri i Zeqir dhe i Habibe, datëlindja 22.05.1966, lindur dhe banues në Gërdoc, Podujevë, Kosovë, me shtetësi kosovare, identifikuar nëpërmjet letërnjoftim me Nr.1013983093, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **10%** e kapitalit fillestar duke depozituar një vlerë prej 10.000 lekë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.

4. Z. Shaban Nexhi, i biri i Qazim dhe i Sofie, datëlindja 21.09.1970, lindur në Perbreg Kukës, banues në Njësia Ad. Tiranë Nr.9, Rr: "Muzakët" Nd.29. H.9 Ap.7, me shtetësi shqiptare, identifikuar me ID Nr. H00901114P, madhor, me zotësi të plotë juridike për të me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **41%** e kapitalit fillestar duke depozituar një vlerë prej 41.000 lekë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.

5. Z. Klodian Maqellara, i biri i Muhamet dhe i Hanke, datëlindja 27.02.1972, lindur në Tiranë, banues në Rr: "Arkitekt Kasemi", Pall.29, Shk.1, Ap.13, me shtetësi shqiptare, identifikuar me ID Nr. H20227126L, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **3%** e kapitalit fillestar duke depozituar një vlerë prej 3.000 lekë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.

Shoqëria do të funksionojë sipas legjislacionit shqiptar.

Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi



Emërtimi i shoqërisë është: **"ALB – USA UNWIRED" SH.P.K**

Neni 3

Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka si objekt:

Shërbimi me fibër optike, antenat, produkte të tjera të teknologjive, importimin e radiove, dizajnimi dhe implementimi i rrjeteve private "LTE Networks", marketingu digjital, analitika e të dhënave e menaxhimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve 5G, dhe jo vetëm.



Neni 4
Selia

Selia e shoqërisë është në adresën: Bulevardi "Zogu i Parë", Rruga "Urani Pano", Nd.1, H.7, Ap.17, Tiranë, Shqipëri.

Transferimi i selisë së shoqërisë në një adresë tjetër bëhet me Vendim të Asamblesë së Ortakëve. Asmableja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me "**me afat të pakufizuar**".

Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Ortakëve ose kur falimenton.

KAPITULLI II
KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TË KAPITALIT


Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë të reja.
Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 5 (pesë) kuota.

Neni 7
Kontributet dhe kuotat

Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë :

- 1. Z. Christopher Grant**, i biri i Alan dhe i Marinella, datelindja 18.08.1976, lindur në Auckland, New Zealand, shtetas i New Zealand, me banim të përkohshëm në Kosovë, adresa 10 K, Ahmet Krasniqi" Prishtin, Kosovë, identifikuar nëpërmjet pasaportës me Nr. LM207546 madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **23%** e kapitalit fillestar duke depozituar një vlerë prej 23.000 lekë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.
- 2. Z. Nenad Rašić**, i biri i Milorad dhe i Slobodanka, datëlindja 27.01.1973, lindur dhe banues në Lipjan, Kosovë, me shtetësi kosovare, identifikuar nëpërmjet letërnjoftim me Nr.1501818522, madhor, me zotësi të plotë juridike për të me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **23%** e kapitalit fillestar duke depozituar një vlerë prej 23.000 lekë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.
- 3. Z. Avdi Kosumi**, i biri i Zeqir dhe i Habibe, datëlindja 22.05.1966, lindur dhe banues në Gërdoc, Podujevë, Kosovë, me shtetësi kosovare, identifikuar nëpërmjet letërnjoftim me Nr.1013983093, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të me zotësi të plotë juridike për



të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **10%** e kapitalit fillestar duke depozituar një vlerë prej 10.000 lekë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.

4. Z. Shaban Nexhi, i biri i Qazim dhe i Sofie, datëlindja 21.09.1970, lindur në Perbreg Kukës, banues në Njësia Ad. Tiranë Nr.9, Rr: "Muzakët" Nd.29. H.9 Ap.7, me shtetësi shqiptare, identifikuar me ID Nr. H00901114P, madhor, me zotësi të plotë juridike për të me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **41%** e kapitalit fillestar duke depozituar një vlerë prej 41.000 lekë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.

5. Z. Klodian Maqellara, i biri i Muhamet dhe i Hanke, datëlindja 27.02.1972, lindur në Tiranë, banues në Rr: "Arkitekt Kasemi", Pall.29, Shk.1, Ap.13, me shtetësi shqiptare, identifikuar me ID Nr. H20227126L, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me **3%** e kapitalit fillestar duke depozituar një vlerë prej 3.000 lekë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.

Neni 8

Rritja e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme të shoqërisë.

Në rast rritjeje të kapitalit, kuotat e ortakëve të shoqërisë do të rriten sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblesë.

Neni 9

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e asamblesë së Shoqërisë.

Në çdo rast, kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji

Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve, sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblesë.

Neni 10

Transferimi i kuotave të kapitalit dhe e drejta e parablerjes

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet e ortakëve, sipas nenit 73 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Në rast të largimit të plotë të njërit prej ortakëve, kuotat e tij i kalojnë menjëherë ortakëve të tjerë në pjesë të barabarta.


Në rast transferimi të pjesëve të kuotave të kapitali në çdo lloj forme në favor të personave të tjerë nga ata të parashikuar më sipër, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim, me çdo kusht, duke përfshirë edhe dhurimin, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto kuota kapitali.

Në një rast të tillë oratku që do të transferojë kuotat e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit.

E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të kapitalit ofruar për shitje.

Ortakët do të kenë në dispozicion 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon pjesën e kuotave të kapitalit, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes.

Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, presumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.



Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e kapitalit të ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt.

Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendim të asamblesë së shoqërisë.

Në rast të transferimit të kuotave të kapitalit për shkak trashëgimie "*mortis causa*", ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj.

Nëse ortakët e Shoqërisë nuk japin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj, kuotat e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht ose pjesërisht, me vendimin e asamblesë së shoqërisë.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 11

Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

1. Vendimet e asamblesë së zakonshme, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët, që përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të të gjithë kapitalit themeltar.
2. Vendimet e asamblesë së jashtëzakonshme, për të cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët që përfaqësojnë më shumë se 70% (shtatëdhjetë për qind) të të gjithë kapitalit themeltar.
3. Nëse asambleja nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në nenin 11 pika 2 e këtij statuti, Asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.
4. Asambleja e jashtëzakonshme vendos me shumicë të kualifikuar prej $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) të votave të ortakëve të pranishëm në lidhje me ndryshimin e Statutit, rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimit, riorganizimin dhe zgjidhjen e shoqërisë.

Në të gjitha rastet e tjera, përveç sa është parashikuar në ligj dhe në statut, Asambleja vendos në mbledhjen e zakonshme me votën e shumicës së ortakëve të pranishëm.



Neni 12

E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave të kapitalit që ai zotëron.

Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër edhe jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.

Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kuotave të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur të kuotave.



Neni 13

Thirrja e Asamblesë së përgjithsme

Asambleja e ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.

Asambleja mund të thirret në çdo moment nga njëri prej administratorëve ose nga një ose disa ortakëve që përfaqësojnë më shumë se 5 % (pesë për qind) të kapitalit themeltar.

Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 15 (pesëmbëdhjetë ditë) përpara mbledhjes së asamblesë.

Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së shoqërisë, e cila ndodhet në Shqipëri.

Mbledhjet e asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet tele-konferencës dhe video-konferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohej atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumentave, pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes.

Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet kryetari, në të cilin duhet të ndodhet edhe sekretari i mbledhjes.

Asambleja do të thirret dhe të mbahet rregullisht edhe pa respektim të formaliteteve të njoftimit, në rast se do të jenë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.

Asambleja vendos mbi ndryshimet në statut, me votën "pro" të ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm.

Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga e njëjta Asamble.

Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 14

Administratorët, emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) administrator dhe maksimumi 3 (tre) administratorë, të cilët qëndrojnë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen e tyre, për një periudhë maksimale prej 3 (tre) vjetësh.

Përfaqësimi ligjor i shoqërisë i besohet Administratorit.

Administratori do të ushtrojë të gjithë kompetencat sipas parashikimeve të nenit 95 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose për kategori aktesh.

Administrator i shoqërisë me themelimin e saj do të jetë personi si më poshtë:

-Z. Shaban Nexhi, i biri i Qazim dhe i Sofie, datëlindja 21.09.1970, lindur në Përbreg Kukës, banues në Njësia Ad. Tiranë Nr.9, Rr: "Muzakët" Nd.29. H.9 Ap.7, me shtetësi shqiptare, identifikuar me ID Nr. H00901114P, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 15

Shkarkimi i Administratori

Administratori i shoqërisë mund të shkarkohet me votën "pro" të ortakëve që përfaqësojnë 66 % (gjashtëdhjetë e gjashtë përqind) të aksioneve.

Neni 16

Eksperti kontabël i autorizuar

Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga asambleja e ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të shoqërisë, mund t'i besohet një ekspert kontabël të autorizuar. Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 17

Viti financiar dhe bilanci vjetor


- Viti financiar fillon me 1 (një) janar dhe mbaron me 31 (tridhjetë e një) dhjetor të secilit vit.
- Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga asambleja me shumicën e përcaktuar sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarët".
- Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 18

Fitimet

Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesë për qind) që caktohen për rezervën ligjore dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumatat që asambleja vendos t'i vërë mënjane, u shpërndahen ortakëve në proporcion me kuotat e kapitalit themeltar të zotëruara.

Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo edhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht apo pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.



KAPITULLI V

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 19

Prishja

Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.

Shoqëria nuk priset në rastin e humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes ose falimentimit të ortakëve.

Neni 20

Likuidimi

Në rast prishjeje shoqëria duhet të likuidohet.

Për të administruar këtë procedurë, asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit ose të pasivitetit të shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimit të procesit të likuidimit.

Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit të ortakëve, në proporcion me kuotat e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 21

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij "Statuti dhe Aktit të Themelimit", si dhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë shoqërisë), ose midis një apo më shumë ortakëve dhe shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara, me ndërmjetësim.

Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore ose me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes, ato do t'i drejtohen për kopetencë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 22

Gjuha e përdorur

Ky statut është i përpiluar në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe, që kanë vlerë të njëjtte ligjore.

Pasi u lexua statuti dhe akti i themelimit me zë të lartë, palët deklaruan se e gjetën atë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre dhe nënshkruhet lirisht prej tyre sipas ligjit.


Christopher Grant

CHRISTOPHER GRANT




Nenad Rašić

NENAD RAŠIĆ




Avdi Kosumi

Avdi Kosumi



Shaban Nexhi



Klodian Maqellara

Klodian Maqellara



Tiranë më, 07.04.2022